

**NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË  
(NJBSC)**

**RAPORTI VJETOR  
(për vlerësimin e proçesit mësimor nga studentët)**

Viti Akademik  
2023-2024

Tiranë, Qershor 2024

## **HYRJE**

### **Garantimi i Cilësisë**

Cilësia ka qënë objektiv parësor që në themelimin e U\_POLIS, dhe është parë si avantazhi konkurrues i institucionit që do e diferencojë në hapësirën e arsimit të lartë në vend dhe rajon.

Në këtë kuptim, të qëniti të vetëdijshëm dhe të vëmendshëm ndaj cilësisë ka qënë një kërkesë e natyrshme e universitetit, edhe përpara se të kthehej në kërkesë zyrtare nga organet shtetërore si MAS dhe ASCAL.

Rritja e institucionit në terma të numrin të studentëve, numrit të stafit por dhe të njësive bazë dhe kryesore, pasurimi i vazhdueshëm i ofertës akademike me programe të të tre cikleve ka sjellë një punë gjithnjë e më të madhe e komplekse të NJSBC

Në anën tjetër, formalizimi i standardeve të cilësisë nga MAS dhe ASCAL, prezenca e ekspertëve të jashtëm në NJSBC që kanë sjellë një ekspertizë shumë të nevojshme në çështjet e cilësisë, konfrontimi dhe bashëkpunimi i vazhdueshëm me partnerët tanë ndërkombëtarë por dhe ngritja e kapaciteteve të brendshme të institucionit në këtë drejtim, kanë bërë që NJSBC të jetë sot një njësi e konsoliduar pranë U\_POLIS, me një mandat të qartë dhe kapacitet të plotë për të hartuar, zbatuar dhe monitoruar një politikë efektive të sigurimit të cilësisë.

Në përpjekjet e tij POLIS udhëhiqet nga parimi se cilësia dhe standarti i procesit mësimor dhe administrativ janë thelbësore. Institucionalizimi i Kulturës së Cilësisë, është një frymë tashmë dominuese në të gjithë stafin që "injektohet" me durim edhe tek studentët. Për të përmbushur këtë qëllim dhe për të garantuar cilësinë në të gjitha elementet e veprimtarisë së Universitetit, me vendim të Senatit Akademik në vitin 2008 u ngrit "Njësia e Cilësisë dhe Akreditimit" (NJCA) si një strukturë e dedikuar për garantimin e cilësisë në të gjitha aspektet e veprimtarisë së universitetit. Në shkurt të vitit 2012 Rektorati i Universitetit rikonsideroi emërtimin dhe përbërjen e NJCA dhe me vendim të Rektoratit Nr. 5 datë 20.02.2012 u vendos riemërtimi i saj nga Njësia e Cilësisë dhe Akreditimit në Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë (NJBSC). Ky emërtim rrjedh nga rikonceptimi, riorganizimi dhe zgjerimi i veprimtarisë së mëparshme në POLIS, në kuadër të politikave për të përmbushur objektivat e tij zhvillimore dhe rritjes së cilësisë.

## NJËSIA E BRENDSHME E SIGURIMIT TË CILËSISË

### 1. Përbërja e NJBSC për vitin akademik 2023-2024

<b>EMËR MBIEMËR</b>	<b>DETYRA</b>
<i>Manjola Hoxha</i>	Kryetar
<i>Edmond Agolli</i>	Anëtar
<i>Merita Guri</i>	Anëtar
<i>Emi Hoxholli</i>	Anëtar
<i>Kejt Dhrami</i>	Anëtar
<i>Anjeza Dajzmaili</i>	Anëtar
<i>Orgejda Deda</i>	Anëtar (Përfaqësues i studentëve)
<i>Gjergji Dushniku</i>	Anëtar (Përfaqësues i ALUMNI)
<i>Anila Zeqo</i>	Anëtar (Përfaqësues Komuniteti i Biznesit)

Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë është konceptuar si një njësi e përhershme, e pavarur, e cila nëpërmjet funksionit të saj kryesor, vlerësimit të cilësisë, synon përmirësimin, rritjen e cilësisë, nxitjen dhe inkurajimin e aktorëve të cilët marrin pjesë në ofertën akademike në mënyrë që të shihet çdo aspekt me syrin e cilësisë, me krijimin dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë në POLIS. Zhvillimi institucional, rritja e gamës së ofertës akademike të POLIS, si dhe dalja e studentëve të parë në tregun e punës, përbëjnë një sfidë serioze dhe vënë në provë cilësinë e programeve akademike dhe rezultateve të mësimnxënies.

Pavarësisht emërtimeve të njësisë ndër vite, qëllimet e NJBSC kanë qenë të njëjta, fokusuar kryesisht në vlerësimin e performancës në procesin mësimor si për stafin akademik ashtu edhe për komponentë të tjerë të lidhur me procesin si bibliografia dhe materialet e studimit, infrastruktura dhe llogjistika.

Disa nga veprimtaritë kryesore të njësisë janë si mëposhtë vijon:

- Analiza në përmbajtje të programeve të studimit, pas marrjes së feedback-ut nga studentët, pedagogët, studentët e punësuar dhe tregu i punës.
- Përqasjen ndërkombëtare dhe ndërkombëtarizimin në formë dhe përmbajtje të programeve që ofron.
- Vlerësimin e aktivitetit kërkimor-shkencor individual dhe institucional si dhe adresimin e përfshirjes së studentëve veçanërisht të cikleve të dyta e të treta të studimit në kërkim konkret bashkëkohor.
- Vlerësimin shumëdimensional të stafit mësimdhënës e mbështetës mbi bazën e treguesve të qartë, specifike e të njohur.
- Vlerësimin në funksion të qëllimit, të fasiliteve burimeve material, logjistikës dhe shërbimeve të tjera ndaj studentëve e komunitetit në përgjithësi, në funksion të programeve të studimit, strategjisë institucionale e objektivave të formimit.
- Vlerësimin e financimit dhe burimeve njerëzore në funksion të proceseve kryesore mësimdhënies dhe kërkimit, si dhe asistimit të studentëve sipas kërkesave e nevojave bashkëkohore të jetës akademike e punësimit.

- Fokusim në dhe vlerësimin e dimensionit kombëtar dhe ndërkombëtar të institucionit, bashkëpunimin me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, ofertën akademike të përbashkët në nivel rajonal e ndërkombëtar si dhe marrëdhëniet me publikun në përgjithësi.
- Vlerësimin e hapjes së marrëdhënieve të institucionit me tregun e punës, lokal, kombëtar rajonal e më gjerë për identifikimin, rritjen e mundësive dhe të cilësisë së punësimit të studentëve të të gjitha niveleve e programve të studimit.
- Vlerësimin e efektshmërisë dhe përputhshmërisë së zhvillimeve në planin institucional, akademik e kërkimor me qëllimet, synimet e objektivat zhvillimore të U\_POLIS.
- Vlerësimi i aspekteve akademike, kërkimore, administrative, menaxheriale mbi bazën e treguesve të përgjithshëm dhe specifike (Tregues të përgjithshëm dhe të veçantë të Performancës), të cilët aktualisht janë në procesin përgatitor.

Në këtë kuadër një prej detyrave më të rëndësishme të NJBSC, është dhe procesi i vlerësimit të cilësië dhe performancës së stafit akademik ne procesin mësimor. Procesi i vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies të stafit akademik përbëhet nga 4 komponentë vlerësimi: nga studentët, kolegët, vetvlerësimi (vetvetja) dhe nga eprori/ët.

✚ *Vlerësimi nga studentët (pesha në vlerësimin total është 50%)*

Universiteti POLIS në filozofinë e vet, studentin e ka pasur gjithnjë në qendër të vëmendjes, duke e parë atë jo vetëm si student, por dhe si bashkëpunëtor në këtë rrugë të gjatë të ngritjes dhe përmirësimit të institucionit. Në përfundim të cdo semestri akademik marrja e mendimeve të studentëve mbi cdo program studimor në tërësi, lëndë të veçantë, pedagog apo mbi një problem specifik nëpërmjet pyetësorëve janë një e dhënë shumë e rëndësishme për përmirësimin e cilësisë në POLIS. Të dhënat e fituara nga këta pyetësorë, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit, ku, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të viti akademik. Përmbajtja e pyetësorëve është standarte dhe konsiston me një interval vlerësimi nga 1 (minimumi i vlerësimit) deri te 5 (maksimumi i vlerësimit). Plotësimi i pyetësorit është konfidencial dhe plotësohet në mënyrë elektronike në sistemin PITAGORA.

✚ *Vlerësimi nga kolegët (pesha në vlerësimin total është 35 %)*

Ky proces që ndryshe është emërtuar (vlerësim nga të barabartët) kryhet nëpërmjet ndjekjes së procesit mësimor nga kolegët. Për realizimin sa me korrekt dhe në kohë njësia ka hartuar një kalendar, nëpërmjet të cilit përcaktohen afatet kohore se kur duhet të përfundojë vlerësimi në fjalë.

✚ *Vetë-vlerësimi (pesha në vlerësimin total është 15%)*

Vetëvlerësimi i pedagogëve është gjykuar si një komponent që dëshmon për shkallën e njohjes që vetë pedagogët kanë për cilësinë dhe kulturën e cilësisë dhe shkallën e vetkritikës me synim përmirësimin e vazhdueshëm individual.

### Vlerësim nga drejtuesit


Vlerësimi i katërt është vlerësimi që realizohet përmes nje procesi analize dhe feedback te kombinuar edhe me analizat semestrale. Gjithashtu vlerësimi që kryhet nga drejtuesit përmes ballafaqimeve e bisedave informale e plotëson kuadrin e vlerësimit nga këndvështrimi i pritshmërive të drejtuesve dhe kërkesave që kanë për cilësinë e aktivitetit akademik. Me stafin e ri ky proces përfshin dhe fokusohet në këshillim, orientim, njohjen me praktikat më të mira me synim përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e sensit vetkritik. Ky vlerësim shërben si vlerësim përfundimtar për performancën e përgjithshme të secilit staf akademik përfshi edhe punën shkencore dhe bazohet në rezultatet e vlerësimit të studentëve, kolegëve dhe të vetëvlerësimit.

## 2. Proçesi i vlerësimit akademik në nivel universiteti

Për vlerësimin e mësidhënies sipas sistemit 360°, kryerja e këtij proçesi bëhet tërësisht online nëpërmjet portalit të posaçëm dedikuar këtij procesi në sistemin elektronik PITAGORA të Universitetit POLIS, gjë që e bën jo vetëm më eficient, më të menaxhueshëm dhe më objektiv. Kryerja e proçesit online garanton vlerësimin në masën 100 % duke gjeneruar raporte më të sakta dhe në një kohë shumë më të shkurtër për tu përdorur nga drejtuesit e njësive në komunikimin e tyre me stafin akademik.


Vlerësimet e studentëve për cilësinë e mësimdhënies, gjatë vitit akademik 2023-2024 janë realizuar nëpërmjet platformës PITAGORA. Si më poshtë jepen të dhëna për % e pjesëmarrjes së studentëve në pyetësor. Këto të dhëna janë në nivel institucional për të patur mundësi krahasimi ndërmjet njësive kryesore (fakulteteve) si dhe në nivel programi.

Grafiku 1. Pjesëmarrja e studenteve në pyetësor e shprehur në % në nivel institucional



Si mëposhtë jepen të dhëna për pjesëmarrjen e studenteve në pyetësor por bazuar sipas programeve perkatese.


Grafiku 2. Pjesëmarrja e studenteve në pyetësor për secilin program studimi




### 3. Krahasimi i vlerësimit të pedagogëve në nivel institucional

Në tabelën e mëposhtme, mund të shikohet vlerësimi që ka marrë stafi për çdo semestër në intervalin 1-5.


Grafiku 1. Vlerësimi në pikë për stafin akademik në nivel universiteti – Semestri i parë



Grafiku 2. Vlerësimi në pikë për stafin akademik në nivel universiteti – Semestri i dytë



Grafiku 3. Vlerësimi në pikë për stafin akademik në nivel universiteti – Vjetor



## **PËRFUNDIME/REKOMANDIME**

Nga rezultatet e vlerësimeve të studentëve të Universitetit POLIS për pedagogët dhe procesin mësimor, nëpërmjet platformës PITAGORA. Në përfundim të procesit rezultoi se stafi akademik i U\_POLIS ka pasur një angazhim dhe përkushtim serioz në procesin e mësimdhënies online dhe të integruar duke arritur rezultate pozitive në vlerësimin e procesit mësimor.

Të gjitha këto të dhëna vendosen në dispozicion të fakulteteve përkatëse me qëllimin përmirësimin dhe krijimin e proceseve për bashkëkohore të mësimdhënies.

- Ngarkohen njësitë kryesore dhe ato bazë të analizojnë me kujdes të gjitha të dhënat grafike të paraqitura në raport, por dhe ato në excel, të dërguara me emra konkretë për secilin staf tek çdo njësi për të zhvilluar takime individuale me secilin staf të vlerësuar dhe angazhuar në procesin mësimor për vitin akademik 2023-2024.
- Të plotësohet formulari i Vlerësimit të Performancës Vjetore për stafin akademik full time duke marrë parasysh edhe vlerësimet e studentëve për procesin mësimor, dhe vetëvlerësimin.
- Rezultatet e detajuara të analizohen për çdo vit studimi për të kuptuar dhe nxituar pjesëmarrje më të lartë të studenteve në pyetësor për vitin në vijim.
- Rezultatet percillen në dekanat, dhe me pas Dekanati ia kalon për analizim departamenteve përgjegjëse, vetëm të dhënat për stafin respektiv.
- Departamenti realizon takime individuale me secilin staf dhe i ben te ditur rezultatin e marre.
- Në rastet kur vlerësimi është maksimal, duhet marrë në konsideratë dhe raporti i studentëve të regjistruar për lëndë me numrin e studentëve që kanë plotësuar pyetësorin.